

EC

MA ND RYSHE

PJESËMARRJA PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR NË KOSOVË

Prizren
Nëntor 2019

PJESËMARRJA PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR NË KOSOVË

Autor: Klodeta Krasniqi

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr: Fehmi Lladrovci 94, Prizren

Bulevardi Nene Tereza, H 30 B1Nr.5

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

029 222 771 & 038 224 957

Ky publikim u realizua ne kuader te projektit "Qytetet Gjithëpërfshirëse - promovimi dhe përhapja e metodologjisë së planifikimit urban me pjesëmarrje", financuar nga Olof Palme International Center mbështetur nga Qeveria e Suedisë. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Olof Palme International Center.



1	HYRJA
3	PJESËMARRJA PUBLIKE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR
5	PJESËMARRJA PUBLIKE DHE AGJENDA 2030
8	PJESËMARRJA PUBLIKE DHE KORNIZA LIGJORE
	Ligji për planifikimin hapësinor
	Ua për pjesëmarrjen publike
	Mekanizmat për fuqizimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e pjesëmarrjes së publikut në procese të planifikimit hapësinor
14	QASJA E KOMUNAVE NË MENAXHIMIN E PJESËMARRJES PUBLIKE NË PLANIFIKIM
19	PJESËMARRJA PUBLIKE NGA KËNDVËSHTRIMI I QYTETARËVE TË PRIZRENIT
27	PËRFUNDIMET
30	REKOMANDIMET
32	EC MA NDRYSHE
33	BIBLIOGRAFIA

Tabela 1. Njohuritë rreth kornizës ligjore dhe mekanizmave të tjerë

Tabela 2. Sfidat në menaxhimin e pjesëmarrjes publike

Tabela 3. Vendi dhe koha e mbajtjes së takimeve publike

Tabela 4. Mjetet e informimit të publikut rreth takimeve publike dhe planeve hapësinore

Tabela 5. Shkalla e përfshirjes së publikut në hartimin e dokumenteve të planifikimit

Tabela 6. Format i takimeve publike

Tabela 7. Përfshirja në fazat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor

Tabela 8. Përfshirja në fazat e përpilit të projekteve kapitale

LISTA E GRAFIKONEVE

Grafikoni 1. Mjetet e informimit rreth takimeve publike

Grafikoni 2. Preferencat gjinore karshi mjeteve të informimit rreth takimeve publike

Grafikoni 3. Format i takimeve publike

Grafikoni 4. Motivi i qytetarëve për pjesëmarrjen në takime publike

Grafikoni 5. Fazat e procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor

Grafikoni 6. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit sipas gjinive

Grafikoni 7. Fazat e procesit të hartimit të projekteve kapitale

Grafikoni 8. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të projekteve kapitale sipas gjinive

Pjesëmarrja publike në planifikim hapësinor në Kosovë është raport analitik kushtuar kornizës ligjore dhe mekanizmave për fuqizimin e kapaciteteve profesionale për menaxhimin e proceseve gjithëpërfshirëse të planifikimit hapësinor, praktikës në qeverisjen lokale dhe qëndrimin e qytetarëve karshi pjesëmarrjes publike.

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe ofrimi i rekomandimeve në funksion të fuqizimit të demokracisë lokale, zhvillimit të proceseve më transparente dhe gjithëpërfshirëse të hartimit të politikave publike, përkatësisht dokumenteve të planifikimit hapësinor. Si i tillë, ky raport ka cak autoritetet përgjegjëse në nivelin qëndror dhe lokal, komunitetin profesional dhe shoqërinë civile.

Përmban gjithësejt gjashtë kapituj. **Kapitulli i parë** ofron një përmbledhje të shkurtër të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, identifikon synimet dhe treguesit në kuadër të kësaj kornize dedikuar pjesëmarrjes publike në zhvillimin urban dhe perceptimit të qytetarëve karshi qeverisjes. **Kapitulli i dytë** ofron përmbledhje të akteve ligjore dhe nënligjore dedikuar pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit, si dhe numëron mekanizmat e tjerë për fuqizimin e kapaciteteve profesionale, përkatësisht modulet trajnuese dhe udhëzuesit dedikur pjesëmarrjes publike në vendimmarrje. **Kapitulli i tretë dhe i katërt** elaborojnë gjetjet nga hulumtimi në terren sa i përket kapaciteteve institucionale dhe qasjes së komunave të Kosovës në menaxhimin e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit, nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike, motivimi i tyre dhe preferencat karshi qështjeve organizative të takimeve të tilla. **Kapitulli i pestë dhe i gjashtë** përveq përfundimeve ofron një set të rekomandimeve për përmirësimin e klimës vendore për procese më të mira gjithëpërfshirëse në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshirë potencialin e Agjendës 2030 si platformë në funksion të institucioneve vendore për matjen e performacës vetanake, shkëmbimin e përvojave me qytetet e tjera dhe mësimi nga praktikatat e mira në nivel global; plotësimet eventuale të kornizës ligjore për të siguruar konsistencë dhe efikasitet të proceseve të tilla; promovimin e mekanizmave ekzistues dhe ngritjes së mëtutjeshme të vetëdijes në mesin e akterëve të ndryshëm rreth rolit dhe rëndësisë së pjesëmarrjes publike në formësimin e politikave publike; aspektet të cilat duhet të konsiderohen për organizimin e takimeve të përshtatshme publike për grupe të ndryshme të komunitetit.

Metodologjia e punës bazohet në shqyrtimin e dokumenteve relevante dhe anketimit me komunat partnere dhe qytetarët. Anketa me zyrtarët komunal është zhvilluar në tetë komuna partnere, përkatësisht Komuna e Prishtinës (2 të anketuar: Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm; Drejtoria e Parqeve), Komuna e Prizrenit (1 të anketuar: Drejtoria e urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit), Komuna e Ferizajt (2 të anketuar: Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit; Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës), Komuna e Gjilanit (1 të anketuar: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës), Komuna e Mitrovicës (1 i anketuar: Drejtoria e Planifikimit Urban), Komuna e Pejës (1 i anketuar: Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit), Drejtoria e Gjakovës (2 të anketuar: Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Drejtoria e Shërbimeve Publike), Komuna e Dragashit (1 të anketuar: Drejtoria e Urbanizmit). Kjo anketë ka adresuar statusin ekzistues të dokumenteve të planifikimit hapësinor, kapacitetet institucionale në menaxhimin e proceseve me pjesëmarrje publike, shkalla dhe formati i takimeve publike, aspekte organizative të takimeve publike.

Anketa me qytetarët është zhvilluar në Komunën e Prizrenit në lagje të përzgjedhura në zonën urbane si Llagjia 11 Marsi, 2 Korriku, Arbanë, Bajram Curri, Bazhdarhane, Dardania, Hoqamahallë, Jenimmahallë, Korillë, Lakuriq, Nashec, Ortakoll, Petrovë, Qoraga, Shatërvan, Shpenadi, Tabakhane, Terzimahallë, L. e Spitalit, L. e Trimave dhe zona rurale si Fshati Billushë, Korishë, Skorobisht dhe Fshati Zhur. Numri total i të anketuarve është 104 persona, prej të cilëve 62 (60%) janë meshkuj dhe 42 (40%) janë femra, ndërsa sa i përket moshës 38 (36%) të grupmoshës 18-25, 63 (61%) të grupmoshës 26-64, 3 (3%) të grupmoshës 65+. Kjo anketë ka adresuar nivelin e njohurisë rreth dokumenteve të planifikimit, niveli dhe fazat e pjesëmarrjes në procese të tilla, përceptimin, motivimin dhe preferencat karshi aspekteve organizative të takimeve publike.

Pjesëmarrja publike është proces gjatë të cilit qytetarët dhe organizatat përfaqësuese të komuniteteve të ndryshme përfshihen në vendim marrje, në identifikimin e problemeve dhe mundësive për zhvillim. Përfshirja e publikut në hartimin e planeve urbane përbën një nga parimet bazë të planifikimit strategjik hapësinor dhe kontribon në ndërtimin e zgjidhjeve zhvillimore më të qëndrueshme dhe të adaptueshme për interesa të akterëve të ndryshëm. Poashtu procese të tilla mund të fuqizojnë demokracinë lokale, besimin në institucione publike, ndjenjën e përkatësisë dhe pronësise ndaj të mirës së përbashkët, fuqizojnë komunitetin dhe qytetarinë aktive.

E drejta për pjesëmarrje shtrohet si e drejtë themelore e banorëve (citadins) në formësimin (prodhimin) e hapësirës urbane nga koncepti i Lefebvres “E drejta ndaj qytetit”, duke vendosur banorin si shfrytëzues të shërbimeve urbane dhe ndërtues të jetës sociale në qytet në qendër. Ky koncept i cili mbështetë një transformim radikal të ndërlidhjes së hapësirës dhe dimensionit social, në mënyrë progresive ka inkurajuar dhe mbështetur iniciativa të shumta në diskursin akademik, politikëbërje dhe në mesin e aktivistëve që ta rimendojnë qytetin si vend për jetesë të shkëputur nga ndikimi i kapitalizmit në ndërveprimin social dhe ngritjen e pabarazive hapësinore në qytete gjatë dy shekujve të fundit (Purcel, 2014).

Vizioni revolucionar i Lefebvres është integruar në kuadër të agjendës globale për të drejtat e njeriut nga agjencione të specializuara të Kombeve të Bashkuara, me qëllim që të stimulojnë politika urbane që promovojnë drejtësi, qëndrueshmëri dhe gjithëpërfshirje në qytete (Purcel, 2002). Për më tepër ky koncept është artikulur në karta ndërkombëtare për qytetin, të cilat sot shërbejnë si pika referimi për zhvillimin e qëndrueshëm urban.



17 SDG

Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm është plan i përbashkët i veprimit i cili ka për qëllim të stimuloj dhe orientoj veprimin gjatë 15 viteve të ardhshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik dhe mjedisor në mënyrë të balancuar dhe integruar. Kjo agjendë është miratuar nga 193 Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian më datë 25 shtator 2015, e cila zbërthehet në 17 qëllime (SDG), 169 synime dhe 230 tregues përkatës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në datën 25 janar 2018 ka miratuar rezolutën për miratim të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me çrast është zotuar që përpjekjet për zhvillim të qëndrueshëm ti bashkërendojnë në funksion të përmbushjes së kësaj agjende.

Agjenda 2030 ndërtohet mbi parimin bazë “leave no one behind”, me çrast gjithëpërfshirja është ndër shtyllat kryesore dhe rrjedhimisht element i integruar në të gjitha qëllimet. Ajo përmabn dy synime dhe dy tregues përkatës që i dedikohen në mënyrë specifike pjesëmarrjes publike në vendim marrje.

Qëllimi 11: Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurt, rezistente dhe të qëndrueshme

Synimi 11.3: Deri në vitin 2030, të zgjerohet urbanizimi në nivel gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të forcohen kapacitetet për planifikimin dhe menaxhimin e vendbanimeve të qëndrueshme, përfshirëse dhe pjesëmarrëse, në të gjitha vendet.

Treguesi 11.3.2: Përqindja e qyteteve me një strukturë pjesëmarrjeje të drejtpërdrejtë të shoqërisë civile në planifikimin dhe menaxhimin urban që funksionojnë rregullisht dhe në mënyrë demokratike.

Qëllimi 16 “Promovimi i shoqërive në paqe dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, siguria e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimi i institucioneve gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse efektive në të gjitha nivelet”.

Synimi 16.7 Të sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet.

Treguesi 16.7.2: Përqindja e popullsisë që beson se vendimmarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme, sipas gjinisë, moshës, aftësisë dhe grupit të popullsisë.

Metodologjia për matjen e këtyre treguesve bazohen në pyetësor si në vijim.

Treguesi 11.3.2 Përqindja e qyteteve me një strukturë pjesëmarrjeje të drejtpërdrejtë të shoqërisë civile në planifikimin dhe menaxhimin urban që funksionojnë rregullisht dhe në mënyrë demokratike.

Duhet të analizohet nga 5 ekspert lokal nga qeveria, akademia, shoqëria civile dhe organizatat ndër-kombëtare në nivel të qytetit. Pyetësori përmban 4 pyetje, përkatësisht:

1. A ekzistojnë struktura për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në planifikimin urban, përfshirë dizajnin dhe marrëveshjeve, të cilat janë direkte, të rregullta/periodike dhe demokratike?
2. A ekzistojnë struktura për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në vendimmarrjen rreth buxhetit në nivel lokal, të cilat janë direkte, të rregullta/periodike dhe demokratike?
3. A ekzistojnë strukturat për vlerësimin dhe informatën kthyesë rreth performancës së menaxhimit urban nga shoqëria civile, të cilat janë direkte, të rregullta/periodike dhe demokratike?
4. A promovojnë këto struktura pjesëmarrjen e grave, djemve dhe vajzave të reja, dhe/apo grupeve të marginalizuara?

Përgjigjet e mundshme janë si në vijim

Nuk pajtohem fuqishëm (1): Nuk ka struktura apo strukturat ekzistuese nuk mundësojnë pjesëmarrje direkte, sistematike dhe demokratike të shoqërisë civile;

Nuk pajtohem (2): Ekzistojnë struktura që mundësojnë pjesëmarrjen e shoqërisë civile, mirëpo janë vetëm pjesërisht direkte, sistematike dhe demokratike;

Pajtohem (3): Ekzistojnë struktura që mundësojnë dhe inkurajojnë pjesëmarrje direkte dhe/apo sistematike dhe/apo demokratike të shoqërisë civile, por jo të trija;

Pajtohem fuqishëm (4): Ekzistojnë struktura që mundësojnë dhe inkurajojnë pjesëmarrje direkte, sistematike dhe demokratike të shoqërisë civile;

Treguesi 16.7.2 Përqindja e popullsisë që beson se vendimmarrja është gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme, sipas gjinisë, moshës, aftësisë dhe grupit të popullsisë.

Anketa duhet të bëhet me mostër reprezentative të qytetarëve. Pyetësori përmban dy pyetje:

1. Sa do të thonit që sistemi politik në vendin tuaj lejon njerëzit si ju të shprehin mendimin në atë që bën qeveria?
2. Sa do të thonit që sistemi politik në vendin tuaj lejon njerëzit si ju të kenë ndikim në politikë?

Përgjigjet e mundshme janë si në vijim:

Aspak; Shumë pak; Pak; Mjaft shumë; Shumë; Refuzues; Nuk e di; Nuk kam përgjigje;

Përderisa treguesi 11.3.2 i dedikohet tërësisht proceseve të planifikimit dhe menaxhimit urban, treguesi 16.7.2 adreson pjesëmarrjen në vendimmarrje në përgjithësi. Të dy treguesit shërbejnë për raportimin e progresit sa i përket performancës së autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e proceseve të tilla dhe përceptimit të popullsisë karshi performancës së tyre.

Kjo kornizë poashtu përcakton metodologjinë e matjes dhe raportimit rreth progresit në përmbushjen e synimeve të lartëpërmendura. Thënë këtë, kjo kornizë shërben si platformë krahasuese me qytete/shtete të ndryshme dhe paraqet mundësi për shkëmbim të përvojave dhe mësim nga praktikrat e mira në nivelin global.

Pjesëmarrja publike në vendim-marrjen lokale është një nga vlerat demokratike që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹, Ligjin nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale², ligje të tjera sektorale dhe aktet nënligjore respektive.

Pjesëmarrja publike në proces të hartimit të planeve hapësinore në nivelin qendror dhe lokal rregullohet me Ligjin nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ MMPH nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor (*UA për pjesëmarrjen publike*).

LIGJI PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

Ky Ligj përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet³, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij ligji.

Pjesëmarrja publike adresohet në kuadër të pesë neneve të ligjit, përkatësisht:

Nenit 3.Përkufizimet, me çrast pjesëmarrjen publike definon si pjesëmarrjen e një ose më shumë personave fizikë apo juridikë, pjesëmarrjen e shoqatave apo organizatave në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor;

Neni 4.Parimet, me çrast (1) promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektorale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, dhe (2) promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, duke siguruar qasje publike për palët e interesuara në të dhëna, harta, grafikone dhe në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor, renditë si dy nga parimet themelore në të cilat duhet të bazohet planifikimi hapësinor në Kosovë;

Sistemi i planifikimit hapësinor është i rregulluar në dy nivele administrative, përkatësisht në nivelin qendror dhe komunal.

Dokumentet e planifikimit hapësinor në nivelin qendror janë :

Plani Hapësinor i Kosovë

identifikon në aspektin hapësinor politikat zhvillimore sociale, ekonomike dhe mjedisore me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar në tërë territorin e Kosovës;

Harta zonale e Kosovës

përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Kosovës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare;

¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës. “Neni 124 [Organizimi dhe Funkcionimi i Vetëqeverisjes Lokale]. Pika 1 (Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në është Republikën e Kosovës komuna. Komunitetët gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale).”

²Ligji nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. “Neni 73 [Komitetet konsultative]. Pika 1 (Kuvendi i komunës themelon komitete këshillëdhënëse sektorale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes).”

Neni 9. Përgjegjësitë e Ministrisë në Planifikimin Hapësinor, me çrast obligon autoritetin qendror të inkurajoj dhe siguroj që pjesëmarrja e publikut është përfshirë në procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor;

Neni 11. Përgjegjësitë e Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor, me çrast obligon autoritetin lokal të inkurajoj dhe siguroj pjesëmarrjen publike në procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, të bëjë njoftimin publik dhe shqyrtimin publik para se të finalizohen këto dokumente;

Neni 20. Pjesëmarrja dhe Shqyrtimi Publik, nen i cili i dedikohet pjesëmarrjes publike në procesin e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në tërësi. Ky nen ka tri pika përmes të cilave obligon autoritetet përgjegjëse në nivelin qendror dhe lokal (1) të menaxhoj procesin në mënyrë efektive gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, të inkurajojnë transparence dhe përfshirje

aktive të kontributit të qytetarëve në vlerësimin e ndikimit potencial social, ekonomik dhe mjedisor të politikave zhvillimore që hartohen, të pranoj peticionet nga pronarët e tokave për ndryshimin klasifikimit të shfrytëzimit të tokës;

(2) që të gjitha dokumenteve të planifikimit hapësinor përmbajnë raportin e shqyrtimit të propozimeve dhe vërejtjeve publike dhe peticioneve nga pronarët e tokave për klasifikimin e shfrytëzimit të tokës në kuadër të planeve hapësinore.

Pika e tretë e nenit 20 obligon autoritetet qendrore që të hartojnë akt të veçant për përcaktimin e përgjegjësive të autoriteteve të planifikimit hapësinor, njoftimit publik, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të debatit publik, trajtimin e peticioneve, si dhe përgatitjen e raportit shqyrtues të propozimeve dhe vërejtjeve publike.

Planet Hapësinore për Zona të Veçanta përcakton vizionin, parimet dhe pikësynimet sektoriale të zhvillimit strategjik për zona me karakteristika të veçanta dhe kërkojnë regjim të posaçëm organizativ, zhvillimor, përdorues dhe mbrojtës.

Dokumentet e planifikimit hapësinor në nivelin komunal janë :

Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor për zonën urbane dhe rurale në territorin e komunës;

Harta Zonale e Komunës (HZK) përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës, kushtet ndërtimore për tokën ndërtimore dhe bujqësore dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare;

Planet Rregulluese të Hollësishme përcakton kushtet për rregullimin e hapësirave të përcaktuara në kuadër të PZHK-së dhe HZK-së.

Ky Udhëzues Administrativ rregullon mënyrën, procedurat, parimet, përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të planifikimit karshi pjesëmarrjes së publikut në këto procese, raportet përkatëse dhe përmbajtjen e tyre si në vijim:

Fazat e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit.

Autoriteti përgjegjës duhet të organizoj të paktën një diskutim publik apo forma të tjera të pjesëmarrjes publike për çdo fazë të procesit të planifikimit hapësinor⁴ dhe shqyrtimin publik para finalizimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Njoftimi i institucioneve publike relevante dhe komunitetit të gjërë rreth takimeve publike.

Njoftimi për diskutimet publike duhet të bëhet së paku 8 ditë para mbajtjes së diskutimit publik përmes ftesave, letrave njoftuese publike, mediave shtetërore apo lokale. Për shqyrtimet publike, ky njoftim duhet të përmbajë vendin, ditën, kohën e fillimit dhe kohëzgjatjen e shqyrtimit publik; listën e dokumenteve që do të diskutohen; vegzën elektronike për qasje në verzionin digjital të dokumenteve të planifikimit hapësinor, afatin kohor, mënyrën dhe adresën elektronike të dërgimit të propozimit dhe vërejtjeve; referenca e parcelave të tokës të cilave u ndërrohet destinimi i shfrytëzimit me dokumentin e planifikimit hapësinor. Përveç njoftimit publik, autoritetet përgjegjëse duhet të njoftojnë në mënyrë të veçant organet publike relevante në nivelin qendror dhe lokal rreth diskutimeve publike dhe shqyrtimit publik për dokumentet e eplanifikimit hapësinor.

Gjithëpërfshirja në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Autoriteti përgjegjës duhet të siguroj gjithëpërfshirjen në diskutime publike. Takimet e tilla duhet të jenë të hapura për të gjithë qytetarët dhe duhet të marrin parasysh nevojat speciale të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, minoriteteve, të rinjëve dhe gjinive të ndryshme. Poashtu, autoriteti përgjegjës duhet të mbajë konsultime me institucionet publike relevante në nivelin qendror dhe lokal në mënyrë që të harmonizojnë dokumentet e planifikimit hapësinor me politikat sektoriale relevante.

Inicimi i shqyrtimit publik për dokumentet e planifikimit hapësinor.

Autoriteti përgjegjës nxjerrë vendimin për mbajtjen e shqyrtimit publik ku përcakton holësisht format e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe akterëve të tjerë në këtë fazë.

⁴ Ligji nr.4/L-174 për Planifikim Hapësinor përcakton përbërjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivelin qendror dhe lokal, ndërsa nuk përcakton në mënyrë decitive fazat e procesit të hartimit të këtyre dokumenteve.

Vërejtjet dhe propozimet e qytetarëve dhe institucioneve të tjera publike rreth dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Autoriteti përgjegjës duhet të ofroj qasje në të dhënat relevante rreth dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshirë të dhënat tekstuale, statistikore dhe hartografike. Vërejtjet dhe propozimet duhet të ofrohen në formë të shkruar nga institucionet publike, ndërsa komuniteti përveq formës së shkruar në librin e vërejtjeve gjatë shqyrtimit publik apo formës elektronike mund të ofroj propozimet, vërejtjet, sygjerimet dhe kërkesën për sqarime shtesë përmes diskutimit me autoritetin përgjegjës për hartimin e dokumenteve të planifikimit gjatë prezantimeve publike në fazën e shqyrtimit.

Raporti mbi shqyrtimin publik.

Autoritetet përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të planifikimit duhet të hartojnë Raportin mbi shqyrtimin publik për projekt dokumentin e planifikimit hapësinor brenda 30 ditëve (për ndryshimin e projekt dokumenteve të planifikimit hapësinor brenda 15 ditëve) pas përfundimit të shqyrtimit publik. Autoriteti përgjegjës përmes këtij raporti duhet të shqyrtoj të gjitha propozimet dhe vërejtjet duke përfshirë edhe petitionet nga pronarët e tokave dhe pronave të ndërtuara, dhe duhet të ofroj përgjigje të argumentuara për miratimin apo refuzimin e propozimeve dhe vërejtjeve të parashtruara. Përmbajtje të tjera të raportit duhet të jenë regjistri i pjesëmarrësve që kanë dhënë propozime dhe vërejtje me shkrim, procesverbalet nga prezantimet dhe diskutimet gjatë shqyrtimit publik.

Raportimi i zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Autoritetet përgjegjëse të planifikimit hapësinor duhet të përpilojnë dhe të komunikojnë me publikun raportet vjetore të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të të gjitha dokumenteve të planifikimit, përmes faqës së internetit të institucionit përkatës, mediave shtetërore dhe lokale dhe formave të tjera.

Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe zhvillimi i mjeteve të punës për mbështetjen e autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin e proceseve të planifikimit hapësinor me pjeëmarrje publike është mbështetur në vazhdimsi nga një numër i konsiderueshëm i partnerëve ndërkombëtar të institucioneve të Kosovës. Mekanizmat e disponueshme janë:

Moduli trajnues “Pjesëmarrja Publike në Planifikimin Hapësinor”.

Ky modul trajnues është i disponueshëm për shërbyesit civil në nivelin qendror dhe lokal në kuadër të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP). Ky modul shtron parimet e procesit të mirëfillt me pjesëmarrje publike, format dhe nivelet e pjesëmarrjes publike në procese të planifikimit hapësinor, udhëzime praktike për zbërthimin e procesit në hapa konkret.

Udhëzuesit për menaxhimin e pjesëmarrjes publike më planifikim hapësinor, dhe vendimmarrje në përgjithësi.

Janë identifikuar 8 udhëzues të përshtatur për kontekstin vendor, 4 prej të cilëve i dedikohen në mënyrë specifike proceseve të planifikimit hapësinor dhe dizajnit urban ndërsa 4 prej tyre adresojnë pjesëmarrjen publike në vendimmarrje në përgjithësi. Këta udhëzues janë publik, dhe akter të ndryshëm si institucionet qendrore, lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët aktiv.

Këta udhëzues janë:

Integrimi gjinor në planifikimin hapësinor: Një qasje hap pas papi për komunitat, UN-Habitat, 2015

Ofron udhëzime përmes të cilave autoriteti përgjegjës siguron adresimin adekuat të nevojave dhe mundësive për të gjitha gjinitë në faza e procesit të planifikimit hapësinor dhe shembuj vendor në aplikimin e kësaj qasje.

Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës, UN-Habitat, 2012

Zbërthen vizionimin si mjet për lehtësimin e inicimit të procesit gjithëpërfshirës të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor, mobilizimit dhe përfshirjes aktive të akterëve të ndryshëm në këto procese.

Udhëzuesi mbi pjesëmarrjen Publike në Planifikimin Hapësinor, UN-Habitat, 2014

Elaboron shkallët e pjesëmarrjes dhe hapat e procesit gjithëpërfshirës në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, si dhe ofron udhëzime metodologjike për organizimin aktiviteteve përkatëse dhe adresimin e sfidave më të shpeshta që hasen në menaxhimin e proceseve të tilla. Ky udhëzues është materiali mbështetës për modulin trajnues “Pjesëmarrja Publike në Planifikimin Hapësinor” të përmendur më lartë.

Udhëzues për planifikimin hapësinor me pjesëmarrje në Kosovë, CHWB, 2015

Ofron përmbledhje të parimeve bazë të pjesëmarrjes së mirë dhe zbërthen planin për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor në nivel lokal-hapat kryesor dhe këshilla praktike në raport me aktivitetet përkatëse. Poashtu, elaboron shkallët e pjesëmarrjes dhe mjete të dëshmuara për të lehtësuar forma të ndryshme të pjesëmarrjes së publikut në procese të tilla.

Udhëzues për menaxhimin e projekteve të investimeve kapitale, UN-Habitat, 2014

Zbërthen hapat e procesit të zhvillimit të projekteve kapitale me pjesëmarrje publike, mekanizmat për përfshirjen e publikut, skemën organizative përfshirë rolet dhe përgjegjësitë e entiteteve respektive.

Fuqizimi i pjesëmarrjes publike në vendimmarrje: në nivel komunal të qeverisjes, INPO, 2018

Definon pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes dhe dobitë që mund të sjellë në komunitet, definon procesin e politikbërjes/ vendimmarrjes dhe mekanizmat e pjesëmarrjes publike në këtë proces, si dhe rolin e komunave dhe OSHC-ve karshi organizimit dhe kontributit në procese të tilla.

Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje në nivel lokal, atrc, 2012

Elaboron format e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, zbërthen dobitë, sfidat dhe mësimet për secilën nga ato.

Udhëzues për procesin e konsultimeve publike, Zyra e Kryeministrit, 2011

Ofron udhëzime për planifikimin dhe organizimin e konsultimeve publike, si dhe në cilat faza të vendimmarrjes të përdoret ky mjet, mekanizmat për adresimin e vërejtjeve apo propozimeve si dhe vlerësimi i konsultimeve publike.

Të gjitha komunat partnere kanë zhvilluar ose janë në proces të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe strategjive të tjera sektorale.

Komuna e Prishtinës, Pejës, Mitrovicës dhe Gjakovës është në proces të hartimit të Planit të ri Zhvillimor Komunal ndërsa të gjitha janë në zhvillim e sipër të Hartës Zonale.

Sa kanë komunat njohuri rreth kornizës ligjore dhe mekanizmave për fuqizimin e kapaciteteve profesionale rreth pjesëmarrjes publike?

Numër i konsiderueshëm i komunave të Kosovës, përkatësisht drejtoritë e urbanizmit dhe dikasteret e tjera relevante, nuk kanë njohuri rreth udhëzimit administrativ për pjesëmarrjen publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mirëpo disa prej tyre janë të njoftuara me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe rregullore tjera që rregullojnë procese të caktuara si psh. buxheti vjetor në vendimmarrjen lokale.

Gjysma e komunave partnere nuk kanë njohuri rreth modulit të trajnimit rreth Pjesëmarrjes Publike në Planifikimin Hapësinor, ndërsa vetëm njëra prej tyre përkatësisht zyrtarët nga Komuna e Pejës ka ndjekur atë.

Sa i përket mekanizmave të tjerë, duke numëruar këtu udhëzuesit e adresuar më lartë, asnjë nga komunat partnere nuk i posedon apo shfrytëzon këto mekanizma për menaxhimin e proceseve të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor.

Tabela 1. Njohuritë rreth kornizës ligjore dhe mekanizmave të tjerë	Po, në Vendimmarrje	Po, në planifikim	Po, rreth modulit trajnues	Po, rreth udhëzuesve	Jo
PRIZRENI					•
PRISHTINA	•				
PEJA	•	•	•		
MITROVICA	•	•	•		
GJILANI			•		
GJAKOVA					•
FERIZAJ	•	•	•		
DRAGASH	•				

Cili është niveli i angazhimit të komunave në menaxhimin e proceseve të gjithëpërfshirëse të hartimit të politikave publike?

Gjysma e komunave partnere konsiderojnë angazhimin vetanë jo të kënaqshëm karshi proceseve gjithëpërfshirëse. Disa nga sfidat kryesore që këto komuna hasin është numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve dhe mungesa e njohurive për menaxhimin e proceseve të tilla në mënyrë adekuate dhe buxheti i pamjaftueshëm. Faktorë tjerë më pak të shprehur që ndikojnë në një performancë të tillë është kohëzgjatja e proceseve me gjithëpërfshirje dhe gjykimi i gabuar rreth rëndësisë së kontributit të komunitetit në procese të tilla, si dhe pjesëmarrja e ulët si rezultat i vetëdijës së ulët në mesin e qytetarëve.

Ku dhe kur mbahen takimet publike?

Takimet publike organizohen në kuvendin komunal dhe objektet publike, ndërsa në masë më të vogël në kafenetë apo hapësirat e tjera në lagjet e targetuara.

Sa i përket periudhës kohore, në shumicën e komunave organizohen nga ora 09.00-12.00 dhe 17.00-20.00, ndërsa në masë më të vogël gjatë periudhës 13.00-17.00 e rrallëherë gjatë kohës së pauzës përkatësisht ora 12.00-13.00. Sa i përket ditëve të takimeve, me përjashtim të komunës së Ferizajt të gjitha komunat organizojnë takimet gjatë vetëm ditëve të punës.

Tabela 2. Sfidat në menaxhimin e pjesëmarrjes publike	Numri i zyrtarëve	Njohuritë profesionale	Buxheti	Vetëdija për rëndësinë	Kohëzgjatja	Vetëdije e ulët e qytetarëve
PRIZRENI	•	•				
PRISHTINA	•	•			•	
FERIZAJ	•	•	•	•	•	
DRAGASH	•	•	•			

Tabela 3. Vendi dhe koha e mbajtjes së takimeve publike	Kuvendi komunal	Objekte publike	Kafene	09.00-12.00	12.00-13.00	13.00-17.00	17.00-20.00
PRIZRENI	•	•			•	•	•
PRISHTINA	•	•		•		•	•
PEJA	•	•	•		•		•
MITROVICA*				•			
GJILANI*				•			
GJAKOVA	•	•		•			•
FERIZAJ	•	•	•	•		•	•
DRAGASH	•	•	•			•	

*Nuk janë përgjigjur lidhur me vendin e takimeve publike.

Cilat janë mjetet e informimit të publikut rreth takimeve publike?

Mjetet më të shpeshta që komunat përdorin për informimin e publikut janë faqja zyrtare e komunës dhe mediat. Forma të tjera të njoftimit janë fletushkat, përmes OJQ-ve lokale, postës elektronike dhe SMS-ev, telefonatat dhe fushatat derë më derë, radio dhe rrejetet sociale.

Tabela demonstroi se disa nga komunat si Peja apo Prizreni kanë eksperimentuar me mjete të ndryshme të informimit dhe mund të shërbejnë si rast i mësimi rreth qasjes dhe mjeteve më efikase për mobilizimin e qytetarëve në masë të kënaqshme.

Tabela 2. Sfidat në menaxhimin e pjesëmarrjes publike	Numri i zyrtarëve	Njohuritë profesionale	Buxheti	Vetëdija për rëndësinë	Kohëzgjatja	Vetëdije e ulët e qytetarëve
PRIZRENI	●	●				
PRISHTINA	●	●			●	
FERIZAJ	●	●	●	●	●	
DRAGASH	●	●	●			

Shumica e komunave partnere bashkëpunojnë me aktor të jashtëm për mobilizimin e qytetarëve në procese të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor si këshillet e banorëve dhe OJQ-të, apo me operatorët ekonomik.

Rrjetet sociale, potencial për mobilizimin e komunitetit në Kosovë

Numri i përdoruesve të internetit në Kosovë gjatë vitit 2019 është 1.86 milion, përkatësisht 88% e numrit të përgjithshëm të popullsisë, me trend të vazhdueshëm të rritjes nga viti në vit. Në top 20-shën e faqeve më të kërkuara në internet janë portalet online si gazeta Express, Telegrafi, Bota Sot, IndexOnline si dhe rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram. Sa i përket rrjeteve sociale, 45% e popullsisë totale janë shfrytëzues të rregullt, prej të cilëve rreth 90% qasen përmes telefonit. Disa nga rrjetet më të frekuentuara sociale janë Facebooku, respektivisht rreth 90% të shfrytëzuesve aktiv, Instagrami me mbi 65% të shfrytëzuesve aktiv, si dhe Tëitter me rreth 7%. Sa i përket aspektit gjinor, Instagram-i ka audiencën më të balancuar (41%F,59%M) në krahasim me Facebook-un (38%F,62%M) dhe Tëitter-in (23%F,77%M).

Në çfarë shkalle përfshijnë komunat publikun në procesin e planifikimit dhe menaxhimit urban?

Shkalla e përfshirjes së publikut në hartimin e strategjive lokale është e ndryshme në komunat e ndryshme. Numri më i madh i komunave informojnë qytetarët rregullisht rreth këtyre proceseve si dhe mbështesin iniciativat e komunitetit për përmirësimin e kushteve/ infrastrukturës publike, përderisa gjysma prej tyre organizojnë takime konsultative publike vetëm dy përfshijnë publikun në kuadër të grupeve punuese dhe veprojnë bashkarisht me qytetarët në zbatimin e tyre përmes bashkëfinancimit, bashkërendimit të interesave rreth investimeve private apo angazhimit të qytetarëve në zbatimin e projekteve.

Sa i përket komunave, Peja ka deklaruar se përfshinë publikun në të gjitha shkallët e pjesëmarrjes.

Formati më i shpeshtë i përfshirjes së publikut është diskutimi publik. grupet punuese apo takimeve punuese. Ndërsa punëtoritë, e në veqanti konkurset apo anketimi janë forma më pak të shfrytëzuara nga komunat.

Tabela 5. Shkalla e përfshirjes së publikut në hartimin e dokumenteve të planifikimit

	Informimi	Konsultimi	Vendime të përbashkëta	Bashkëveprim/ bashkëfinancim	Mbështetja e iniciativave
PRIZRENI		•	•		•
PRISHTINA		•		•	•
PEJA	•	•	•	•	•
MITROVICA	•				
GJILANI	•			•	
GJAKOVA	•	•			•
FERIZAJ	•				•
DRAGASH	•				•

Tabela 6. Format i takimeve publike

	Grupet punuese	Takimet në lagje	Diskutime publike	Punëtori	Anketim	Konkurset
PRIZRENI	•	•	•	•		•
PRISHTINA	•		•	•		•
PEJA	•	•	•	•	•	
MITROVICA	•	•	•			
GJILANI	•	•	•			
GJAKOVA	•	•	•	•		
FERIZAJ		•	•			
DRAGASH			•			

Në cilat faza përfshijnë komunitat publikun në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe të projekteve kapitale?

Në shumicën e rasteve komunitat kanë përfshirë publikun në identifikimin dhe vlerësimin e problemeve, mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e planit të veprimit, ndërsa në masë më të vogël në përcaktimin e vizionit dhe zbatimin e planit.

Ndërsa sa i përket menaxhimit të projekteve kapitale të gjitha komunitat kanë përfshirë publikun në identifikimin e problemeve dhe në masë të madhe në përcaktimin e projekteve për zbatim.

Komunitat e Ferizajt, Prishtinës dhe Pejës kanë deklaruar se janë angazhuar që të përfshijnë grupet më të disfavorshme në procesin e hartimit të strategjive apo projekteve kapitale përmes dëgjimeve publike, takimeve publike dhe punëtorive gjithëpërfshirëse.

Tabela 7. Përfshirja në fazat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor	Mbledhjen e të dhënave	Vlerësimi i gjendjes ekzistuese	Vizioni, qëllimet dhe objektivat	Plani i aktiviteteve	Zbatim
PRIZRENI		•		•	•
PRISHTINA	•	•	•		
PEJA	•	•	•	•	•
MITROVICA	•	•		•	
GJILANI	•	•		•	
GJAKOVA	•	•	•		
FERIZAJ	•	•	•	•	•
DRAGASH					

Tabela 8. Përfshirja në fazat e përpilimit të projekteve	Identifikimi i problemeve	Përcaktimi i projekteve	Projekti ideor	Zbatim
PRIZRENI	•	•	•	•
PRISHTINA	•	•		
PEJA	•	•		
MITROVICA	•	•		
GJILANI	•	•		
GJAKOVA	•	•	•	
FERIZAJ	•	•	•	•
DRAGASH	•		•	

Sa kemi njohuri rreth dokumenteve të planifikimit hapësinor?

Pjesa dërmuese e të anketuarve, përkatësisht 70% kanë njohuri apo kane dëgjuar për dokumentet e planifikimit hapësinor.

Pothuajse ¼ e të anketuarve, përkatësisht 22% e tyre nuk kanë dëgjuar asnjëherë për to. Përqindja e femrave brenda grupit vetanak gjinor është pothuajse e dyfishtë në raport me atë të meshkujve që renditen në këtë kategori, përkatësisht 16 % e meshkujve në raport më 31% të femrave nuk kanë dëgjuar asnjëherë për këto dokumente.

Numri i personave që i kanë konsultuar këto dokumente është relativisht I vogël. 75% e e tyre janë meshkuj, ndërsa asnjë femer nuk e ka konsultuar dokumentin për tu informuar rreth pronës së tyre.



78%
e atyre që nuk
kanë njohuri



79%
e grave nuk kanë
njohuri rreth
mandatit apo
nuk kanë
dëgjuar fare



8%
i kanë
konsultuar
planet

Burimet e informimit rreth dokumenteve të planifikimit dhe procesit të hartimit të tyre janë të ndryshme. Numri më i madh i të anketuarve përkatësisht 36% deklarojnë se janë informuar nga mediat, 28% nga OJQ-të, 20% nga të afërmit e tyre, 14% nga zyrtarët komunal, 11% nga fletushkat informuese ndërsa 4% nga rrjetet sociale.


Cila formë e njoftimit rreth takimeve publike do të ishte më bindëse për mua?

Preferencat e qytetarëve karshi mjeteve të informimit rreth dokumenteve të planifikimit dhe procesit të hartimit të tyre nuk janë në përputhje të plotë me burimet më të shpeshta prej të cilave informohen tani.


Pjesa më e madhe e të anketuarve preferojnë mjetet zyrtare të informimit duke renditur si të parat informimin drejt-përdrejt nga zyrtarët komunal apo mediat, fletushka apo materiale të tjera të shtypura të shpërndara nga komuna. Përderisa OJQ-të, rrjetet sociale dhe të afërmit janë kanale më pak të preferuara të informimit.

Sa i përket aspektit gjinor, vërehen dallime më të theksuara sa i përket pranimi të informatës drejtëpërdrejt nga zyrtarët komuna, përderisa ajo renditet e para për femrat për meshkuj renditet e treta në listën e mjeteve më të preferuara për informim. Dallim tjetër më i theksuar vërehet tek fletushkat, përderisa ka një pajtueshmëri pothuajse të plotë sa i përket mediave.

51% e të anketuarve konsiderojnë se forma e njoftimit rreth takimeve të tilla është faktor i rëndësishëm përderisa 22% jo edhe aq.



Grafikoni 1. Mjetet e informimit rreth takimeve publike



Grafikoni 2. Preferencat gjinore karshi mjeteve të informimit

A janë duke u hartuar dokumente të planifikimit tani për tani?

Komuna e Prizrenit është në proces të hartimit të Hartës Zonale të Komunës, drejtoria bartëse është Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Ndërsa në mesin e strategjive lokale të përfunduara dhe aprovuara nga komuna janë Plani Zhvillimor Komunal, Plane Rregulluese për disa nga lagjet urbane, Planin për Zonën Historike të Prizrenit.

68%

Nuk kanë njohuri si të qasen në dokumentet e planifikimit hapësinor

80%

Nuk kanë njohuri nëse komuna është duke hartuar ndonjë dokument të planifikimit hapësinor

67%

Nuk kanë parë apo pranuar thirrje për të marrë pjesë në procese të tilla

22%

E personave që kanë parë apo pranuar thirrje për takime publike janë gra

86%

Do të kishin marr pjesë në takime publike, shumica (75%) prej të cilëve besojnë se kontributi i tyre është qenësor në këto procese

78%

Nuk kanë informatë rreth nivelit të zbatimit të dokumenteve të planifikimit


A kemi marr pjesë të takime publike në proces të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor?

35% e të anketuarve kanë marr pjesë në takime publike. Forma më e shprehur e pjesëmarrjes është diskutimi publik, takimet në lagje ndërsa në masë më të vogël pjesëmarrësit kanë kontribuat në anketave, në cilësi të pjesëmarrësit në grupet punuese apo punëtori.


Nga të anketuarit që kanë marrë pjesë në takime publike pjesa më e madhe, respektivisht 47% besojnë se kontributi i tyre është qenësor në këto procese, ndërsa 16% prej tyre kanë marrë pjesë sepse kanë qenë kurioz rrëth takimit;

Një nga brengat më të theksuara që kontribuojnë në motivimin e qytetarëve për të marr pjesë në takime publike është roli i tyre dhe deri në çfar niveli mund të ndikojnë në vendimmarrje, ku 46% e tyre (37% e atyre që kanë qenë pjesë dhe 51% e atyre që nuk kanë marr pjesë në takime publike) nuk besojnë se mendimet e tyre to të mirreshin parasyshë. Shkaqe të tjera që dekurajojnë pjesëmarrjen e qytetarëve është koha e papërshtatshme apo mungesa e besimit dhe njohurisë se si mund të kontribuojnë në procese të tilla.

Sa i përket aspektit gjinor faktori i kohës (75%f,25%m) dhe të kuptuarit rreth mandatit të këtyre dokumente si instrumente që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë (61%f,39%m) janë sfida më të shprehura tek femrat se sa tek meshkujt.




Grafikoni 3. Formati i takimeve publike



Grafikoni 4. Motivi i qytetarëve për pjesëmarrjen në takime publike


Në cilat faza të procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor kemi marr pjesë?

Qytetarët e anketuar kanë marr pjesë në 5 faza të hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Numri më i madh i pjesëmarrësve kontribuar në përcaktimin e vizionit, qëllimeve dhe objektivave, të cilat janë komponentet kyqe që orientojnë zhvillimin dhe përcaktojnë fushat me prioritet për investim. Gjithësesi përcaktimi i planit të aktiviteteve, ku niveli i pjesëmarrjes është relativisht i ulët, është faza përmbyllëse e hartimit të strategjive lokale dhe kontributi i qytetarëve është kyq në zberthimin e objektivave në projekte adekuate që kontribojnë në përmbushjen e vizionit dhe adresojnë sfidat që ata i hasin në baza ditore.



Grafikoni 5. Fazat e procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor

Sa i përket dimensionit gjinor, vërehet një diskrepancë e theksuar në pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në faza të ndryshme të procesit. Një kompozicion i tillë mund të rezultoj me dokumente të planifikimit hapësinor më të disfavorshme për grupet më të heshtura apo jo prezente në procese të tilla.




Grafikoni 6. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit sipas gjinive

Në cilat faza të procesit të përpilimit të projekteve kapitale kemi marr pjesë?


Qytetarët e anketuar kanë marr pjesë në 4 faza të hartimit dhe zbatimit të projekteve kapitale. Numri më i madh i pjesëmarrësve kontribuar në identifikimin e problemeve, përderisa një numër relativisht i vogël ka kontribur në përcaktimin e projekteve, përpilimin e konceptit zhvillimor në kuadër të projektit ideor dhe zbatim.

Sa i përket dimensionit gjinor, sikur në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit, vërehet një diskrepancë e theksuar në pjesëmarrjen e femrave dhe meshkujve në faza të ndryshme të procesit sidomos në fazën e identifikimit të problemeve.

Identifikimi jo adekuat i problemeve dhe prioritetëve mund të rezultoj në projekte kapitale që krijojnë kushte urbane dekurajuese për grupe të prioritetëve caktuar të shoqërisë.



Grafikoni 5. Fazat e procesit të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor



Grafikoni 8. Pjesëmarrja në procesin e hartimit të projekteve kapitale sipas gjinive

Ku mbahen vs. ku do të doja të mbahen takimet publike?

55% e të aknetuarve kanë deklaruar se vendi i takimit është i rëndësishëm për ta, ndërsa 16% jo dhe aq. Sa i përket aspektit aspektit gjinor në mesin e femrave 62% e tyre kanë deklaruar se vendi përbën faktor të rëndësishëm për to, ndërsa në mesin e meshkujve rreth 50%.

46% do të preferonin që takimet të mbahen në kuvendin komunal

36% ♀♂ 50%



52% konsiderojnë se takimet publike mbahen në kuvendin komunal

59% do të preferonin që takimet të mbahen në objekte apo hapësira të tjera publike

64% ♀♂ 50%



38% konsiderojnë se takimet publike mbahen në objekte apo hapësira të tjera publike

11% do të preferonin që takimet të mbahen në kafene

4% ♀♂ 14%



10% konsiderojnë se takimet publike mbahen në kafene

Kur mbahen vs. kur do të doja të mbahen takimet publike?

63% të të anketuarve kanë deklaruar se koha e takimit është e rëndësishme, përderisa 8% kanë deklaruar se koha nuk është e rëndësishme për ta.



15%

preferojnë
periudhën kohore
09.00-12.00



8%

preferojnë
periudhën kohore
12.00-13.00



16%

preferojnë
periudhën kohore
13.00-17.00



61%

preferojnë
periudhën kohore
17.00-20.00

64% do të preferonin që
takimet të mbahen gjatë
ditëve të fundjavës



Komuna e Prizrenit ka
konfirmuar se takimet
publike i mbanë gjatë
ditëve të punës

78% e atyre që kanë deklaruar që nuk do të merrnin pjesë në takime publike kanë deklaruar se koha është e rëndësishme dhe në masë të madhe preferojnë periudhën kohën 17.00-20.00 dhe mediat si formë e informimit.

Gjithëpërfshitja prioritet global.

Agjenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm integron pjesëmarrjen publike përmes dy synimeve dhe indikatorëve respektiv në kuadër të prioritetëve në nivelin global, dhe e konsideron si një nga mjetet për ndërtimin e qyteteve të qëndrueshme dhe më të jetueshme për të gjithë, institucione më transparente dhe më të përgjegjshme.

Korniza ligjore. Korniza ligjore në Kosovë bazohet në parimet e qeverisjes së mirë duke siguruar procese transparente dhe gjithëpërfshirjen në vendimmarrje. Si e tillë përmes një Udhëzimi Administrativ që rrjedh nga Ligji për Planifikimin Hapësinor rregullon pjesëmarrjen publike në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në nivelin qëndror dhe lokal, përfshirë këtu përgjegjësitë e institucioneve përkatëse në menaxhimin e këtyre proceseve, fazat e pjesëmarrjes publike në hartimin e dokumenteve të planifikimit, njoftimin e institucioneve publike relevante dhe komunitetit të gjërë rreth takimeve publike, inicimit të shqyrtimit publik për dokumentet e planifikimit hapësinor, format e grumbullimit dhe qasja në adresimin e vërejtjeve dhe propozimeve të qytetarëve dhe institucioneve të tjera publike rreth dokumenteve të planifikimit hapësinor në fazën e shqyrtimit publik, raportimin mbi shqyrtimin publik dhe raportimin rreth zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Gjithësesi, janë identifikuar një numër i zbrazëtive që duhet të adresohen për konsolidimin e mëtutjeshëm të këtyre akteve ligjore sa i përket pjesëmarrjes publike:

- UA për pjesëmarrjen publike vë theksin në shqyrtimin publik i cili është hapi përfundimtar i përfshirjes së publikut në hartimin e dokumenteve të tilla, përderisa sa i përket fazave të tjera përcakton kohën e njoftimit dhe obligon autoritetet përgjegjëse që të ketë konsultime publike në secilën prej tyre. Duke pasur parasysh kapacitetet institucionale për menaxhimin e proceseve gjithëpërfshirëse, orientimet që ky udhëzues ofron janë të pamjaftueshme për organizimin e mirëfillt të fazave paraprake të hartimit të planeve hapësinore.
- Ligji për planifikimin hapësinor përcakton përmbajtjen e secilit prej planeve si në nivelin qëndror edhe lokal, mirëpo nuk përcakton në mënyrë specifike cilat janë fazat e hartimit të këtyre dokumenteve. Ndërsa UA për pjesëmarrje publike në kuadër të parimeve përcakton në mënyrë specifike përfshirjen e publikut në caktimin e vizionit, objektiveve dhe prioritetëve strategjike të cilat adresohen vetëm nga disa dokumente të planifikimit hapësinor, përderisa komponentet të caktuara si mbledhja e të dhënave, vlerësimi i situatës ekzistuese, përcaktimi i masave dhe kushteve zhvillimore, përcaktimi i aktiviteteve etj nuk adresohen fare. Thënë këtë ky udhëzim lë të hapur përcaktimin e

fazave të hartimit të këtyre dokumenteve dhe rrjedhimisht organizimin e procesit në mënyrë individuale për autoritetet përgjegjëse.

- Një numër i konsiderueshëm i komunave të Kosovës nuk kanë njohuri rreth UA për pjesëmarrje publike. Sipas anketës me 8 komunat më të mëdha në Kosovë, vetëm 3 nga komunat, përkatësisht 32.5%, kanë deklaruar se kanë njohuri rreth UA-së në fjalë.

Portfolio e pasur e mjeteve metodologjike. Ekziston një numër i konsiderueshëm i mjeteve metodologjike për fuqizimin e kapaciteteve njerëzore si institucionale dhe të tjera për menaxhimin e proceseve gjithëpërfshirëse në hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, dizajnit urban dhe vendimmarrje në përgjithësi. Sa i përket udhëzuesve për proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit, ato kryesisht ofrojnë udhëzime shumë të thukta për procesin e hartimit të PHK apo PZHK-së, e cila mund të adaptohet edhe për strategji të tjera sektorale, mirëpo jo edhe dokumentet e tjera të planifikimit si HZK apo PH. Sa i përket informimit dhe shfrytëzimit të këtyre burimeve nga niveli lokal, një numri më i madh i komunave nuk ka ndjekur trajnimin rreth Pjesëmarrjes Publike në Planifikimin Hapësinor ndërsa asnjëra prej tyre nuk shfrytëzon udhëzuesit ekzistues për menaxhimin e proceseve të tilla në punën e tyre ditore.

Angazhim i kufizuar i komunave karshi proceseve gjithëpërfshirëse. Komunat kanë përvojë në përfshirjen e publikut në procese të planifikimit hapësinor, mjedisor, menaxhimit të projekteve kapitale, ofrimit të shërbimeve publike dhe përpilimit të buxhetit vjetor. Disa nga komunat kanë zhvilluar procese me pjesëmarrje publike në të gjitha fazat duke përdorur forma të ndryshme të njoftimit dhe përfshijes së komunitetit dhe akterëve të tjerë relevant. Gjithësesi disa nga sfidat që një numër i konsiderueshëm i tyre hasin janë kapacitete të pamjaftueshme njerëzore si në aspektin numerik dhe profesional sa i përket menaxhimit të këtyre proceseve dhe vetëdijës rreth rëndësisë së pjesëmarrjes publike, si dhe buxheti i pamjaftueshëm.

Njoftimi i publikut dhe akterëve të tjerë rreth dokumenteve të planifikimit dhe takimeve publike. Numri më i madh i komunave shfrytëzon mjetet e njoftimit në përputhje me UA për pjesëmarrje publike si faqja zyrtare e komunës apo gazetatat lokale, përderisa vetëm disa prej tyre shfrytëzojnë edhe forma të tjera për informimin dhe mobilizimin e publikut në procese të tilla si bashkëpunimi me OJQ-të lokale apo operatorët ekonomik, postës elektronike, fushata derë më derë, telefonatat dhe SMS-et, radio dhe rrjetet sociale. Ndërsa nëse bazohemi në Komunën e Prizrenit, format tradicionale të informimit të publikut rreth këtyre takimeve nuk janë shumë efektive, sidomos sa i përket komunitetit të grave dhe vajzave. Numër i konsiderueshëm i qytetarëve të Prizrenit nuk janë

informuar rreth proceseve të mëhershme apo ato aktuale të hartimit të dokumenteve të tilla, si mund t'u qasen planeve ekzistuese apo deri në çfarë mase janë zbatuar ato. Për më tepër, në masë të madhe nuk kanë fare informatë apo kanë njohuri të ulët rreth mandatit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Gjithësesi, mjetet më të preferuara të informimit janë kanalet zyrtare të njoftimit si informimi i drejtëpërdrejtë nga zyrtarët komunal, mediat e transmetuara dhe të shtypura, fletushkat apo materiale të tjera të shtypura.

Kuvendi komunal dhe objektet e tjera publike, adresa kryesore e takimeve publike. Takimet publike organizohen kryesisht në kuvendin komunal, ndërsa në raste më të rralla në objekte të tjera publike. Ky trend është në shpërputhje të lehtë me preferencat e qytetarëve, bazuar në rastin e Komunës së Prizrenit, ku numri më i madh i qytetarëve të anketuar sidomos në mesin e grave dhe vajzave preferojnë objektet apo hapësirat publike në afërsi të lagjeve të tyre.

Ditët e punës vs. ditët e fundjavës për takimet publike. Takimet publike, me disa përjashtime, organizohen gjatë ditëve të punës dhe varësisht nga komuna në kohë të ndryshme të ditës duke renditur si raste më të shpeshta periudhën kohore 09.00-12.00 dhe 17.00-20.00. Ndërsa sa i përket ditës dhe kohës së parapëlqyer për takimet publike nga qytetarët, në masën më të madhe kanë fundjavën dhe periudhën kohore 17.00-20.00.

Përceptimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në takime publike. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (35%) kanë marr pjesë në takime publike kryesisht në në formatin e diskutimit publik apo takimeve në lagje, prej të cilëve gjysma besojnë se kontributi i tyre është qenësor në zhvillimin e dokumenteve më të mira të planifikimit hapësinor. Ndërsa disa nga arsyet kryesore të mospjesëmarrjes janë besimi i ulët se mendimi i tyre do të mirret parasysh por gjithëashtu njohuri e pamjaftueshme rreth rolit dhe kontributit potencial të tyre në procese të tilla. Gjithësesi pjesa më e madhe e tyre (86%) do të merinin pjesë në takime publike sepse besojnë se kontributi i tyre do të ishte qenësor në këto procese.

Agjenda 2030 si mundësi për procese më transparente dhe gjithëpërfshirëse. Kjo agjendë përmes treguesve të dedikuar pjesëmarrjes publike në vendimmarrje dhe procese të hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor mund të shërbej si platformë për matjen dhe raportimin e progresit rreth performancës së komunës në menaxhimin e proceseve të tilla, si dhe vlerësimin e përceptimit të qytetarëve rreth nivelit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në qeverisjen lokale. Matja e këtyre treguesve në mënyrë sistematike do t'i shërbente komunës të identifikoj dhe reflektoj rreth sfidave për rritjen e besueshmërisë tek qytetarët dhe të menaxhimit të proceseve më transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive. Poashtu duke qenë se këta tregues janë të unifikuar, SDG-të mund të shërbejnë si platformë krahasuese me qytetet e tjera në nivel të Kosovës, regjionit dhe më gjërë, dhe mundësi e mësimi nga përvojat e suksesshme.

Kornizë e konsoliduar ligjore. UA për pjesëmarrjen publike duhet të plotësohet më tutje në mënyrë që të promovoj dhe të ofroj orientime të qarta për autoritetet përgjegjëse në përfshirjen aktive të të gjithë akterëve relevant në të gjitha fazat e hartimit të dokumenteve të planifikimit. Dy aspektet kryesore të këtij udhëzuesi që duhet të plotësohen janë (1) përcaktimi i fazave të pjesëmarrjes publike për të gjitha dokumentet e planifikimit dhe (2) definimi i rezultateve të pritura nga takimet publike për fazat respektive. Një nga format se si kjo mund të realizohet është plotësimi i UA-së me anekse, përkatësisht modelet e planeve të pjesëmarrjes publike për secilën nga dokumentet e planifikimit hapësinor.

Plotësimi dhe promovimi i mekanizmave lokal për fuqizimin e kapaciteteve profesionale për menaxhimin e proceseve gjithëpërfshirëse. Portfolio ekzistuese e udhëzuesve dhe mekanizmave të tjerë të fuqizimit të kapaciteteve për lehtësimin e pjesëmarrjes publike kryesisht adreson procesin e hartimit të strategjive hapësinore dhe proceseve vendimmarrëse në përgjithësi. Kjo portfolio duhet të plotësohet më tutje me udhëzues që trajtojnë në mënyrë specifike pjesëmarrjen publike në dokumentet me karakter rregullativ si HZKos, HZK dhe PH. Kjo paketë, duke përfshirë udhëzimin administrativ dhe udhëzuesit në fjalë, duhet të promovohet në mesin e komunave dhe akterëve të tjerë relevant si OJQ-të dhe operatorët e ndryshëm ekonomik.

Ngritja e vetëdijes rreth rëndësisë së pjesëmarrjes dhe proceseve gjithëpërfshirëse. Përpjekje të shtuara duhet të bëhen në tri nivele të ndryshme për ngritjen e vetëdijes rreth rëndësisë së pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes aktive në vendim marrje.

(1) Ngritja e vetëdijes së institucioneve përkatëse rreth rëndësisë së këtij faktori në

formësimin e politikave publike që promovojnë zhvillim të qëndrueshëm social, mjedisor dhe ekonomik, janë më të përshtatshme dhe më të adaptueshme për nevojat e akterëve të ndryshëm, që adresojnë sfidat kyçe që qytetarët i hasin dhe promovojnë prosperitet.

(2) Fuqizimi i OJQ-ve në mënyrë që të jenë ura lidhëse më efektive në mes të komunitetit që përfaqësojnë dhe institucioneve lokale, duke mbështetur organizimin e proceseve më adekuate që sigurojnë pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme të komunitetit në procese të tilla, duke transmetuar në mënyrë adekuate njohurinë lokale dhe të ndikojnë agjendën lokale në favor të komunitetit të gjërë, sidomos grupeve më të cënueshme.

(3) Informimin më të mirë të komunitetit rreth rolit dhe rëndësisë së kontributit të tyre në formësimin e politikave lokale, duke komunikuar nevojat dhe sfidat që kanë, dhe duke u shprehur karshi prioriteteve dhe propozimet që adresojnë këto nevoja më së miri.

Mjetet alternative të informimit të komunitetit rreth takimeve publike. Autoritetet përgjegjëse duhet të eksperimentojnë në kërkim të formave më efektive të njoftimit të qytetarëve rreth takimeve publike, rëndësisë dhe formës se si ata mund të kontribojnë. Duke patur parasysh që trendi i përdorimit të telefonave celular dhe rrjeteve sociale është në rritje, përdorimi i tyre si mjet për informimin e qytetarëve rreth rëndësisë së pjesëmarrjes aktive dhe takimeve publike mbetet si potencial i pashterrur. Institucionet publike mund të shfrytëzojnë platforma të tilla për komunikim më të drejtpërdrejt me qytetarët si për identifikimin e problemeve duke targetuar lokacione apo grupe të caktuara të komunitetit, për testimin e propozimeve apo informimin rreth mbarvajtjes së proceseve të till.

Organizimi i takimeve të përshtatshme publike. Nevojat, prioritetet, forma si ndërveprimë me hapësirën dhe qasja në burime është e ndryshme për komunitete të ndryshme varësisht nga mosha, gjinia, statusi shoqëror, vendi apo etnia. Dokumentet e planifikimit hapësinor dhe politikat e tjera publike duhet të adresojnë nevojat dhe prioritetet e të gjithë qytetarëve, pa dallim moshe, gjinie, statusi shoqëror, vendi apo etnie. Rrethimisht institucionet publike duhet të kenë laramani në qasjen ndaj komunitetit, duke përshtatur mjetet e qasjes dhe përfshirjes në proces për grupe të caktuara. Faktor të rëndësishëm për organizimin e takimeve të përshtatshme publike për grupe të ndryshme të komunitetit janë mjetet e informimit, formati dhe gjuha e komunikimit gjatë takimit, vendi, koha dhe përbërja. Varësisht nga qëllimi i takimit, rezultatet e pritura dhe grupet e targetuara autoritetpërgjegjëse duhet që në bashkëpunim me përfaqësues të komunitetit të jenë të vemendshëm karshi aspekteve të lartëpërmendura dhe të angazhohen në organizimin e takimeve të përshtatshme publike në mënyrë që të rezultojmë me dokumente të përshtatshme të planifikimit hapësinor.

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar ne vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse.

EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

EC angazhohet për qytete/komuna gjithëpërfshirëse në Kosovë. Organizata beson në vlerën e shtuar që sjell angazhimi i gjithësecilit në qeverisjen e qyteteve/komunave dhe në veçanti e atyre që kanë më pak qasje dhe mundësi për të ndikuar. Në punën e saj 13 vjeçare EC është fokusuar në mobilizimin e komunitetit duke u dhënë prioritet grupeve të nënpërfaqësuar. Ky angazhim e ka vendosur EC-in në krye të organizatave të komunitetit në Kosovë. Një nga metodologjitë dalluese të EC-it është ajo e planifikimit urban me pjesëmarrje, rezultatet e së cilës janë tejet të prekshme në komunën e Prizrenit.

Për shumë qytetarë të Prizrenit, por edhe për disa lokacione të tjera në Kosovë, EC shihet si adresë shumë kredibile për çuarjen tutje të nevojave, kërkesave dhe interesave komunitare. EC ka punuar dhe vazhdon të punëojë ngushtë me PAK, të moshuarit, gratë dhe vajzat, banorët e lagjeve informale, komunitetet joshumicë, artistët, ambientalistët dhe shumë të tjerë në baza ditore në përpjekjen e përbashkët për t'i kthyer nevojat e qytetarëve në vendime e veprime të institucioneve. Në të njëjtën kohë, EC ka ndërtuar grupe lokale të komunitetit në nivel të lagjes dhe fshatit në komunën e Prizrenit, ndërsa nga viti 2018 këtë praktikë po e bart edhe në komunat e tjera të Kosovës (deri në 2020 synohet zgjerimi deri në dhjetë komuna). Përveç angazhimit komunitar, EC njihet edhe për avokimin konsistent në mbrojtje të strukturës urbane të qyteteve të Kosovës, me fokus në vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Përmes rrjetit të gjerë të profesionistëve me të cilët bashkëpunon në baza të rregullta, EC ka zhvilluar standarde të larta të cilësisë sa i përket shërbimeve që i ofron dhe produkteve që i realizon. Organizata ka qenë dhe vazhdon të jetë kontribuese e drejtpërdrejtë e hartimit të një numri të konsiderueshëm politikash publike në nivel qendror dhe lokal. Në të njëjtën kohë, EC ka prezencë të shtuar edhe rajonale dhe ndërkombëtare përmes mekanizmave të rëndësishëm të rrjetëzimit profesional dhe të shoqërisë civile.

United Nations General Assembly,
TRANSFORMING OUR WORLD: THE 2030 AGENDA FOR SUSTAINABLE
DEVELOPMENT(2015)

<http://habitat3.org/wp-content/uploads/NUA-English.pdf>

UN Department of Economic Affairs and Social Affairs, Metadata repository SDG 11.3.2
(2018)

<https://unstats.un.org/sdgs/metadata/files/Metadata-11-03-02.pdf>

UN Department of Economic Affairs and Social Affairs, Metadata repository SDG 16.7.2
(2017)

<https://unstats.un.org/sdgs/metadata/files/Metadata-16-07-02.pdf>

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rezoluta për miratim të Objektivave të Zhvillimit të
Qëndrueshëm (2015)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008)

http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf

Gazeta Zyretare e Republikes se Kosoves, Ligji nr. 03/I-040 për vetëqeverisjen lokale
(2008)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Gazeta Zyretare e Republikes se Kosoves, Ligji nr. 04/I-174 për planifikimin hapësinor
(2013)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8865>

Gazeta Zyretare e Republikes se Kosoves, Udhëzimit Administrativ MMPH nr.05/2014
për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat
për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor (2014)

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10226>

CHwB, Udhëzues për planifikimin hapësinor me pjesëmarrje në Kosovë (2015)

<http://chwb.org/kosovo/Publication/guidebook-for-participatory-spatial-planning-in-kosovo-2/?lang=sq>

INPO, Fuqizimi i pjesëmarrjes publike në vendimmarrje: në nivel komunal të qeverisjes
(2018)

<http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2018/01/Doracaku-Fuqizimi-i-Pjes%C3%ABmarries-Publike-n%C3%AB-Vendimmarrje-INPO.pdf>

ATRC, Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje në nivel lokal (2012)

<http://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2018/09/PjesemarrjaQytetareNeVendimmarrjeNeNivelLokal.pdf>

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Udhëzues për procesin e konsultimeve publike (2011)

https://www.kcsfoundation.org/ëp-content/uploads/2017/12/Udhezuesi_per_procesin_e_konsultimeve_publike_b5.pdf

UN HABITAT, Udhëzues për menaxhimin e projekteve të investimeve kapitale (2014)

<https://unhabitat-kosovo.org/wp-content/uploads/2014/11/1.-Udhezues-per-menaxhimin-e-Projekteve-te-Investimeve-Kapitale.pdf>

UN HABITAT, Programi për Mbeshtetje të Planifikimit Hapësinor Komunal, Vizionimi si mjet i planifikimit pjesëmarrës te mesuarit nga praktikat e Kosoves (2012)

http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/Visioning-ALB_584536.pdf

UN HABITAT, Udhëzues mbi pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor (2014)

http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/3._Udhezues_mbi_Pjesemarrjen_Publike_ne_Planifikimin_Hapesinor_388034.pdf

Republika e Kosoves, Asociacioni I Komunave te Kosoves (2015)

http://www.unhabitat-kosovo.org/repository/docs/Gender_Mainstreaming_ALB_web_172353.pdf

Hootsuite, Digital 2019 Kosovo (2019)

<https://www.slideshare.net/DataReportal/digital-2019-kosovo-january-2019-v01>

Mark PURCELL, Possible worlds: Henri Lefebvre and The Right To City, University of Washington, USA (2014)

http://faculty.washington.edu/mpurcell/jua_rtc.pdf

Mark PURCELL, Excavating Lefebvre: The right to the city and its urban politics of the inhabitant, University of Washington, USA (2002)

<https://faculty.washington.edu/mpurcell/geojournal.pdf>